

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “TERMO GREEN”

Bazuar në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më date 01 Prill 2021 themeluesit:

1. **Semih KURT**, i biri i **Şahin Kurt**, lindur me **11/09/1987** ne Stamboll, Turqi banues ne Tirane, Rruga **Rexhep Shala**, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. **033587926** dhe numer personal **I70911113T**.
2. **Gerian KUKA**, i biri i **Reshat Kuka**, lindur me **23/03/1974** ne Tirane, Shqiperi banues ne Rruga **Dervish Hima**, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. **032850126** dhe numer personal **H40323152I**

#### Deklaroj se:

Kam vendosur të nënshkruaj në këtë Kontratë Themelimi, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**TERMO GREEN**” SHPK. më poshtë referuar si “Shoqëria”.

Veprimtaria e Shoqërisë do të rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

#### Neni 1 – Emërtimi

Shoqëria emërtohet “**TERMO GREEN**” SHPK. Emërtimi mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

#### Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë “**TERMO GREEN**”. është ne adresen: Tirane, Njesia Nr. 14 , Rruga Rexhep Shala, Ndertesa 3, Hyrja 4, Ap 29.

Shoqëria mund të hap si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

#### Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

#### Neni 4 – Objekti



Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

Import-Eksport i materialeve të ndryshme ndertimi si veshje murale, suva me baze gelqere, suva me baze cemento, suva me shtrese të holle dhe suva të çdo lloji materiali tjetër, kolle, rrafshues, materiale për hidroizolim të jashtëm dhe të brendshëm, materiale për fasada të jashtëme, muret e brendshme, tavanet, dyshemet etj. Import-eksporti dhe tregtimi me shumice dhe pakice i gurit të të gjitha llojeve, qeramik, pllakave, mermerit, lendes dhe materialeve të ndertimit, makinerive impianteve, mjeteve, pajisjeve që shërbejnë për ndertim, pjesëve të kembimit, paneleve diellore dhe me rreze infra, pajisjeve elektroshtepiake, elektronike, elektrike, hidrosanitare, hidraulike, qera mike, qelqi, artizanati, duralumini, lendeve të para, të lendes drusore të përpunuar dhe të papërpunuar, mobiljeve, materialeve e lendeve të para të të gjitha llojeve, lendeve plastike, gome, hekuri, linjash e makinerish në fushën e prodhimit, përpunimit, transportit, artikujve e produkteve ushqimore, bujqësore, blegtorale, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmes apo plotësues në funksion të objektit kryesor të shoqërisë me qëllim realizimin e objektit të mesipër shoqëria mund të marrë pjesë në çfarëdo lloj marrëveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqëri të tjera e sipërmarrje si edhe të kryejë çdo akt tjetër të nevojshëm.

#### **Neni 5 – Kapitali i regjistruar**

Kapitali themeltarë i shoqërisë “**TERMO GREEN**” është 1 000 (njemije) Leke.

#### **Neni 6 – Kuotat e kapitalit të Regjistruar**

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si me poshtë vijon:

Ortaku themelues **SEMIH KURT**: Zotëues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 700 leke që përben 70% të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku themelues **GERIAN KUKA**: Zotëues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300 leke që përben 30% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar

#### **Neni 7 – Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjestimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nga Statuti i Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Administrimi**



Administratori i shoqërisë do të jete **SEMIH KURT**, me numer identifikimi personal **I70911113T**, i cili do të ushtroje të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit tregtare të shoqërisë duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konforme me legjislacionit shqiptar.

Administratori emërohet për 5 (pese) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që ta shkarkoj atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë dhe me shumë se një administrator, i cili mund të ketë çfarëdo lloje nënshtetësie. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në detyrë, të gjithë administratorët do të jenë vec e vec ose bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ana e ligjit administratorëve.

### **Neni 9 – Të tjera**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **Neni 10**

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet, që mund të lindin, gjatë ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve për t' i zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juriksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **Neni 11**

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje me vlerë të njëjtte juridike.

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**


#### **“TERMO GREEN”**

**Gerian KUKA**



*Tirre me datë  
04/04/2021*

**Semih KURT**

*Semih Kurt*  


# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TERMO GREEN"

Ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", ne:

1. **Semih KURT**, i biri i **Şahin Kurt**, lindur me **11/09/1987** ne Stamboll, Turqi banues ne Tirane, Rruga **Rexhep Shala**, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. **033587926** dhe numer personal **I70911113T**.
2. **Gerian KUKA**, i biri i **Reshat Kuka**, lindur me **23/03/1974** ne Tirane, Shqiperi banues ne Rruga **Dervish Hima**, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. **032850126** dhe numer personal **H40323152I**

, nënshkruajne statutin si me poshtë vijon:

### NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Emri i shoqerise eshte "**TERMO GREEN**"

### NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë "**TERMO GREEN**". eshte ne adresen: Tirane, Njesia Nr. 14 , Rruga Rexhep Shala, Ndertesa 3, Hyrja 4, Ap 29.

Shoqeria mund të hap si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

### NENI 3 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqërisë është **pa afat**. Shoqëria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Qendren Kombëtare te Biznesit (QKB) Tirane.

### NENI 4 OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:



Import-Eksport i materialeve te ndryshme ndertimi si veshje murale, suva me baze gelqere, suva me baze cemento, suva me shtrese te holle dhe suva te cdo lloji materiali tjeter, kolle, rrafshues, materiale per hidroizolim te jashtem dhe te brendshem, materiale per fasada te jashtme, muret e brendshme, tavanet, dyshemet etj. Import-eksporti dhe tregtimi me shumice dhe pakice i gurit te te gjitha llojeve, qeramik, pllakave, mermerit, lendes dhe materialeve te ndertimit, makinerive impianteve, mjeteve, pajisjeve qe sherbejne per ndertim, pjeseve te kembimit, paneleve diellore dhe me rreze infra, pajisjeve elektroshtepiake, elektronike, elektrike, hidrosanitare, hidraulike, qera mike, qelqi, artizanati, duralumini, lendeve te para, te lendes drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, mobiljeve, materialeve e lendeve te para te te gjitha llojeve, lendeve plastike, gome, hekuri, linjash e makinerish ne fushen e prodhimit, perpunimit, transportit, artikujve e produkteve ushqimore, bujqesore, blegtorale, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjeter te nevojshem, ndihmes apo plotesues ne funksion te objektit kryesor te shoqerise me qellim realizimin e objektit te mesiperme shoqeria mund te marre pjese ne cfaredo lloj marreveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqeri te tjera e sipermarrje si edhe te kryeje cdo akt tjeter te nevojshem. .

## NENI 5 KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE

Kapitali themeltare i shoqerise "**TERMO GREEN**" është 1 000. (Njemije) Leke.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte vijon:

Ortaku themelues **SEMIH KURT**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 700 leke qe perben 70% te kapitalit te shoqerise.

Ortaku themelues **GERIAN KUKA**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 300 leke qe perben 30% te kapitalit te shoqerise.

Kapitali themeltar mund te zvogëlohet ose mund te rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

## NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali i saj fillestar, nga pasuri te luajtshme ose te paluajtshme dhe nga te tjera pasuri qe jane dhene dhe do te jepen te cilat jane te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.

## NENI 7

Kuotat e kapitalit themeltare do te derdhen nga ortaku ne Banke, ne llogarinë bankare ne emër te shoqërisë, dhe derdhjet e kuotave regjistrohen ne librin e llogarive te shoqërisë.

#### **NENI 8**

Fitimet e shoqërisë i takojne ortakut te saj. Asambleja e përgjithshme vendos ne baze te ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

#### **NENI 9**

Shoqeria tregtare "**TERMO GREEN**",  
eshte përdoruese dhe mbajtese e pasurise se krijuar. Ajo mund te marri dhe te ushtroje te drejta te tjera, materiale dhe jo materiale, përfshire dhe te drejtën e shitjes se pasurisë se krijuar te treteve.

#### **NENI 10**

Shoqëria "**TERMO GREEN**",  
vepron ne regjimin e pronësisë private dhe merr përsipër te gjitha detyrimet dhe te drejtat brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket marrin përsipër rrezikun e aktivitetit te shoqërisë vetëm brenda limitit te kapitalit themeltar te investuar ne te.

#### **NENI 11**

### **DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQERISE**

Bëjnë pjese ne detyrimet dhe kompetencat e ortakeve, te mbledhur ne asamble te përgjithshme, te gjitha ato qe janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe te listuar ne këtë statut.

Nder këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi ne aktin e themelimit dhe ne statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, te veprimtarisë se administrimit, te inventarit, te bilancit te llogarisë vjetore;
3. emërimi dhe shkarkimi i administratoreve ortake e jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave te tyre, duke përcaktuar se qofte për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do te jete e domosdoshme te jepet shprehimisht një shkak;
4. miratimin i huave dhe i garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet qe kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës se vulës dhe te markës se shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit te shoqërisë;

8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
10. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive të shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë shoqëria;
13. vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qofte persona fizike qofte juridike;
14. vendimin për ndarjen e kotave dhe për anulimin tyre;
15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
17. vendimin për shitjet e kuotave të shoqërisë;
18. vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër;
20. në shtim të kompetencave normale të asamblesë së ortakëve, në bazë të ligjit në fuqi, janë kompetence e ortakut vendimet që kanë të bëjnë me aktet e blerjeve ose i dhënieve të të drejtave reale imobiliare ose të dhënieve të garancive reale personale.

#### **NENI 12**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike.



Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

#### **NENI 13**

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



#### NENI 14

Administratori i shoqërisë do të jete **Semih Kurt**, me numer identifikimi personal **I70911113T**, i cili do të ushtroje të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit tregtare të shoqërisë duke aplikuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konforme me legjislacionin shqiptar.

Administratori emërohet për 5 (pese) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që ta shkarkoj atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë dhe me shumë se një administrator, i cili mund të ketë çfarëdo lloje nënshtetësie. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në detyrë, të gjithë administratorët do të jenë vec e vec ose bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ana e ligjit administratorëve.

#### NENI 15

Administratori kryen detyrat e ngarkuara nga ortaket e shoqërisë në këtë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të përcaktuara nga ligji. Midis këtyre detyrave janë të përfshira ato që renditen më poshtë:

1. të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të shoqërisë;
2. të kryej detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe nga statuti, të përpunojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznes për vitin financiar, mbi të cilin do të aprovohet në asamblenë e përgjithshme; punësimet, pagat, pushimet nga puna, masat disiplinore në ngarkim të punonjësve, miratimin e kërkesave për dorëheqje nga vendi i punës;
3. të përpunojë dhe të prezantojë për miratimin para asamblesë së përgjithshme raportet mbi aktivitetin e shoqërisë dhe bilancin e mbylljes së vitit ushtrimor të vitit të kaluar, në bazë të asaj që është parashikuar nga ligji;
4. të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
5. Administratori (ose administratorët nëse do të emërohen me vone të tjerë) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tremeve për shkeljet e ligjit ose të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, në bazë të ligjit shqiptar;
6. të kryej të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
7. të përfaqësojë Shoqërinë tregtare;




8. te merret me mbajtjen e dokumenteve dhe te librave te llogarive te shoqërisë me korrektese dhe saktesi;
9. te kryej regjistrimin dhe te dërgoje te dhënat e nevojshme te shoqërisë, ashtu sic eshte parashikuar nga ligji per Qendrën Kombëtare te Biznesit;
10. ti raportoje asamblesë se përgjithshme realizimin dhe kryerjen e politikave tregtare dhe per sa i përket realizimit te aksioneve specifike te një rëndësie te veçante ne aktivitetin e shoqërisë tregtare;
11. te emëroje financiere, likuidatorë dhe konsulentë per problemet e shoqërisë. Financieri jep llogari ne mënyre te rregullt te tregueseve financiar, çdo tremujor, gjashtëmujore dhe vjetor për aktivitetin e shoqërisë;
12. te administroje me korrektësi dhe vëmendje shoqërinë;
13. te kontraktoje marrëveshje me te tretet ne limitet e objektit te aktivitetit dhe te kompetencave te përcaktuara nga ortaku;
14. te aplikoje rregulloren e brendeshme te shoqërisë;
15. te pergjigjet per demet e sjella shoqërisë nga veprimet e tij;
16. te paguhet per punën qe kryen ne baze te marrëveshjeve te bëra me ortakun themelues;
17. te informohet dhe te beje propozime per çfarëdolloj gjeje qe e vlerëson te dobishme për shoqërinë;
18. te kryej te gjitha aktivitetet bankare qe kane lidhje me llogarinë e shoqërisë;
19. administratori ka te drejte dhe detyrim për mbledhjen e asamblesë se përgjithshme, ne baze dhe duke zbatuar dispozitat e neneve 12 dhe 13 te këtij statuti dhe te ligjit ku nuk është e përfshire ne statut.

## **NENI 16 DETYRIMET DHE TE DREJTAT E SHOQËRISË**

Shoqëria ka te drejte:

1. te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. te siguroje pasurinë e tij;
3. te marre kredi ne leke dhe ne valute te huaj nga Bankat vendase ose te huaja ne baze te normave ligjore;
4. te përfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera ;
5. te investoje kudo ne Shqipëri, me te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj;
6. te punësoje punëtorë, vendas ose te huaj;



7. te eksportoje lirisht valutën qe ka realizuar nga fitimet e saj.

#### **NENI 17**

Shoqëria ka për detyre:

1. te siguroje kapitalin e shoqërisë ne formën dhe kohen e duhur;
2. te japë garanci për shërbimet qe kryen shoqëria;
3. te siguroje punonjësit e saj;
4. te plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktore ndaj cilitdo;
5. te respektoje standardet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **NENI 18**

### **RAPORTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TE SHOQERISE**

I gjithë aktiviteti i shoqërisë për plotësimin e objektit te saj, pasqyrohet ne bilancin e saj ekonomik.

#### **NENI 19**

Ne selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te cilit, brenda datës 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci, konform legjislacionit ne fuqi.

#### **NENI 20**

Viti financiar fillon me një Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **NENI 21**

Shoqëria mban nje llogari te shoqerise ne Banke.

#### **NENI 22**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve te vitit te mëparshëm, le mënjanë 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi “Rezerve i domosdoshem”, derisa ky fond te arrije masën 10% te kapitalit themeltar.

#### **NENI 23**

### **DISPOZITA TE VECANTA**

Shoqëria ka vulën e saj dalluese dhe mund te ketë një marke te saj.

#### **NENI 24**

### **TRASFORMIMI DHE SHPERBERJA E SHOQERISE**

Shndërrimi i shoqërisë “**TERMO GREEN**”  
, ne shoqëri te tipeve te tjera, mund te behet me vendim te ortakut themelues sipas mënyrave te parashikuara nga ligji.

#### **NENI 25**

Shpërbërja e shoqërisë, mund te vije për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe per arsyet si me poshte:

- humbja e kapitalit te shoqërisë;
- pamundësi per veprim;
- me vendim të Asamblese se pergjithshme te Ortakeve.

Ne këto raste Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se shoqërisë deri sa ajo t’u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave te trete.

Ne rast se fondet te disponueshme, rezultojnë te pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve te shoqërisë, likuidatori mund t’i kërkoje ortakëve themelues te shoqërisë qe te derdhin tërësisht kuotat qe i takojnë atije.

#### **NENI 26**

Per sa nuk është parashikuar shprehimisht ne këtë statut, do ti referohet legjislacionit shqiptar si edhe ndryshimeve te mëvonshme qe do te kryen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve sipas ligjit, ne formën e aktit publik.

#### **NENI 27**

Statuti përpilohet ne 4 (kater) kopje, te nënshkruara rregullisht nga ortakët.


### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

#### **“TERMO GREEN”**

**Gerian KUKA**



**Semih KURT**



Tirane me Dety  
01/09/2021